

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ngërçi për pagat, përfundon mbledhja e jashtëzakonshme e 271 gjyqtarëve, çfarë u diskutua – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/ngerci-per-pagat-perfundon-mbledhja-e-jashtezakonshme-e-271-gjyqtareve-cfare-u-diskutua/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 13:08:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 13:06:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8e226bd2abde7c5c1cece39a5124bfb7a9392b4d4282b72dadfbc0ac37a275d2
TEKSTI	f19e365f113053f255c9488a529f3ca9022e018e36386408a965bc08d6d008ee
PAMJA	e48811becc3c5a9ce7d100bf6df430585efd8441166bd4b13014c55476b31498

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8512e92adeb3a2b4d954cd9b056f30ebcee9d7a6825873668c34ac98930e1e2d
E MËPARSHMJA	763b8a87d776b29e88fc62cdf60a9a90f8c3310410941b20d0c862a9319c8ba8
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8512e92adeb3a2b4d954cd9b056f30ebcee9d7a6825873668c34ac98930e1e2d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



gjqësore.

Deklarata e plotë:

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, e thirrur në mënyrë të jashtëzakonshme për shkak të bllokimit të pagave të gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore, pasi shqyrtoi situatën e krijuar dhe qëndrimet institucionale të mbajtura gjatë këtyre ditëve, deklaroi sa vijon:

1. Situata e krijuar nuk përbën një mosmarrëveshje të zakonshme financiare dhe as një konflikt për privilegje. Ajo prek drejtpërdrejt autoritetin e Kushtetutës, forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe funksionimin e rregullt të gjykatave. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15/2026 është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim. Asnjë organ shtetëror nuk mund t'i pezullojë, kushtëzojë ose neutralizojë efektet e tij me akt administrativ, me interpretim financiar apo me mosveprim.
2. Pas datës 31 korrik 2026, formula e shpallur antikushtetuese nuk mund të vazhdojë të zbatohet. Mosveprimi i ligjvënësit brenda afatit të caktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk e ringjall normën e shfuqizuar dhe nuk krijon vakancë në mbrojtjen që neni 138 i Kushtetutës i njeh pagës së gjyqtarit. Garancia kushtetuese nuk mund të vihet në pritje deri në një vendim marrje të ardhshme dhe as të varet nga vullneti i organit që administron fondet publike.
3. Vendimi nr. 435, datë 26 gusht 2026, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është akti i organit kushtetues përgjegjës për administrimin e sistemit

5 Bëgjaj uron nisjen e vitit të ri shkollor!
Besoni te vetja dhe tek ëndrrat,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emëlli juaj

Abonohu

gjyqësor, i miratuar për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Çdo kundërshtim ndaj tij duhet të ndiqet vetëm me mjetet dhe përpara organeve që parashikon ligji. Derisa të ndryshohet ose të shfuqizohet në rrugë ligjore, ai prodhon pasoja dhe duhet të zbatohet. Thesari nuk ka kompetencë të kryejë kontroll kushtetues apo gjyqësor mbi të dhe nuk mund të shndërrohet nga mekanizëm ekzekutimi, në mekanizëm pezullimi.

4. Edhe nëse pretendohet se ekziston një çështje për t'u zgjidhur lidhur me pagën pas datës 31 korrik 2026, kjo nuk mund të përdoret si shkak për të bllokuar detyrimet e prapambetura. Për to, paragrafi 110 i vendimit nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese ka dhënë zgjidhje të shprehur. Një detyrim i përcaktuar për një periudhë të përfunduar nuk mund të mbahet peng nga debati për një periudhë tjetër. Ai duhet të ekzekutohet pa vonesë dhe pa u kushtëzuar nga miratimi i një ligji të ri.
5. Bllokimi i pagave ka prekur njëkohësisht gjyqtarët dhe administratën gjyqësore. Sekretarët gjyqësorë, kancelarët, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të gjykatave, janë pjesë e domosdoshme e funksionimit të drejtësisë dhe nuk mund të mbajnë mbi familjet e tyre pasojat e një mosmarrëveshjeje që nuk e kanë krijuar. Lënia e tyre pa pagë cenon dinjitetin njerëzor e profesional, dëmton funksionimin e gjykatave dhe, në fund, kufizon shërbimin e drejtësisë ndaj qytetarit. Pagesat e administratës gjyqësore nuk janë pjesë e qëndrimit refuzues të Ministrisë së Financave dhe degëve të thesarit për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
6. Paga e gjyqtarit është pjesë e statusit kushtetues dhe garanci konkrete e pavarësisë në ushtrimin e funksionit. Ajo nuk është favor i ekzekutivit, shpërblim që jepet sipas vlerësimit të tij apo instrument për të shprehur miratim ose pakënaqësi ndaj vendimmarrjes gjyqësore. Mbrojtja e kësaj garancie nuk i shërben vetëm gjyqtarit; ajo mbron qytetarin, i cili ka të drejtë të gjykohej nga një gjyqtar i pavarur nga çdo pushtet tjetër.
7. Buxheti i shtetit është instrument financiar i Republikës dhe duhet të sigurojë funksionimin e të gjitha pushteteve të saj. Mungesa e planifikimit, nevoja për rishpërndarje fondesh ose vështirësi të tjera administrative nuk mund ta kthejnë një detyrim kushtetues e ligjor në detyrim fakultativ. Në një shtet kushtetues nuk është Kushtetuta ajo që përshtatet me buxhetin; është buxheti që duhet të mundësojë zbatimin e Kushtetutës.
8. Përballë kësaj situatë, Mbledhja e Përgjithshme vlerëson se nuk ka më vend për shtyrje, interpretime që relativizojnë detyrimin apo zgjidhje të pjesshme që e lënë gjendjen të vazhdojë. Rivendosja e ligjshmërisë kërkon veprime të menjëhershme, të plota dhe të verifikueshme nga institucionet përgjegjëse. Për këtë arsye,

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve kërkon:

- Zhbllokimin e menjëhershëm dhe pagesën pa asnjë vonesë të pagave të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore;
- Zbatimin e plotë të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, të vendimit nr. 435, datë 26 gusht 2026, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të urdhrave të nëpunësve autorizues të gjykatave, për aq kohë sa këto të fundit janë në fuqi;
- Sikurse organet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kanë njohur dhe ekzekutuar detyrimet ligjore, duke zbatuar referencën e pagës sipas parametrave ligjorë të konfirmuara nga vendimi nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. 435,

datë 26 gusht 2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve pret nga Ministria e Financave dhe organet në varësi, që të mos zbatojnë vetëm detyrimet ligjore që gjyqtarët kanë por edhe të drejtat e tyre;

- Fillimin e menjëhershëm të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura sipas zgjidhjes së përcaktuar në paragrafin 110 të vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, si një detyrim kushtetues i cili nuk varet nga miratimi i ligjit të ri;
- Miratimin pa vonesë të kuadrit të ri ligjor, në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nenin 138 të Kushtetutës, garancitë kushtetuese të statusit të magjistratit dhe pas një konsultimi real me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë;
- Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve do të refuzojë të pranojë çdo propozim dhe zgjidhje ligjore, që nuk garanton paprekshmërinë e pagës dhe përfitimeve të tjera të ligjshme të gjyqtarëve, në parametrat ligjorë të konfirmuara nga vendimi nr. 15/2026 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr. 435, datë 26 gusht 2026 i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Ndalimin e çdo praktike administrative që pengon funksionimin financiar të gjykatave ose vendos gjyqtarët dhe administratën gjyqësore përpara pasigurisë së përsëritur për pagën e tyre;
- Marrjen e përgjegjësiwe institucionale nga çdo organ që, sipas Kushtetutës dhe ligjit, ka kompetencë për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera dhe për të rivendosur menjëherë gjendjen e ligjshme;
- Ndërmarrja e çdo lloj mjeti ligjor me natyrë administrative, civile dhe kushtetuese që bën të mundur ekzekutimin me efekt të menjëhershëm të listëpagesave të pagave të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, në zbatim të vendimit nr. 435, datë 26.8.2026 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe urdhrave të titullarëve të gjykatave respektive;
- Ndërmarrja e të gjitha iniciativave për adresimin e situatës me organizatat ndërkombëtare, veçanërisht me Komisionin Evropian, instancat e tjera ndërkombëtare si dhe përfaqësitë diplomatike të huaja, të angazhuara në mbështetjen dhe monitorimin e ndërtimit të shtetit të së drejtës dhe reformës në drejtësi në Shqipëri;
- Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve i kërkon Presidentit të Republikës, në zbatim të kompetencave të tij kushtetuese, të angazhohet për respektimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore;
- Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve i kërkon Presidentit të Republikës monitorimin me rigorozitet të projektligjit të propozuar nga deputetët e Kuvendit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016", me qëllim që propozimet për ndryshime të ligjit të jenë në përputhje me frymën, standardet dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15/2026 dhe të sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të tij;
- Në rast se nuk veprohet menjëherë nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ekzekutimin e pagave, masat e ndërmarra nga pushteti gjyqësor do të përshkallëzohen deri në reduktimin dhe kufizimin përkohësisht të veprimtarisë gjyqësore, vetëm në shqyrtimin e çështjeve me natyrë urgjente dhe që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme gjyqësore.

Këto kërkesa nuk janë objekt negocimi, sepse nuk burojnë nga një interes i çastit dhe as nga një pretendim i pakonfirmuar. Ato burojnë nga

Kushtetuta, ligji dhe nje vendim përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese.
Dialogu institucional është i nevojshëm për të përcaktuar mënyrën e zbatimit, por nuk mund të përdoret për të shtyrë, relativizuar apo vënë në diskutim vetë detyrimin për zbatim.

Gjyqtarët e Republikës do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e tyre me përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe me respekt të plotë për Kushtetutën e ligjin. Kjo përgjegjësi nuk nënkupton heshtje përballë cenimit të garancive të pushtetit gjyqësor. Vetëpërmbytja e gjyqtarit është virtutet institucionale; ajo nuk mund të interpretohet si pranim i paligjshmërisë apo si dorëzim përballë saj.

Mbledhja mbështet përdorimin e të gjitha mjeteve kushtetuese dhe ligjore për rivendosjen e ligjshmërisë dhe kërkimin e përgjegjësisë, duke ruajtur në çdo rast paanshmërinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave që mund të thirren për shqyrtimin e këtyre çështjeve. Reagimi ynë do të jetë në një zë të vetëm, i matur në zgjedhjen e mjetit dhe i vendosur deri në zbatimin e plotë të ligjit.

Mbledhja e Përgjithshme u bën thirrje Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës që t'i japin menjëherë fund kësaj gjendjeje dhe të përmbushin detyrimet e tyre kushtetuese e ligjore. Vazhdimi i bllokimit pas këtij qëndrimi të përbashkët nuk mund të konsiderohet më një paqartësi teknike: ai do të përbënte vijim të vetëdijshëm të një situatë që cenon autoritetin e Gjykatës Kushtetuese, pavarësinë e gjyqësorit dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Gjyqësori nuk kërkon epërsi ndaj pushteteve të tjera dhe nuk pranon nënshtrim ndaj tyre. Kërkon vetëm atë që Kushtetuta urdhëron: që secili pushtet të ushtrojë kompetencat e veta, të respektojë kufijtë e tjetrit dhe t'u bindet vendimeve përfundimtare të drejtësisë kushtetuese.

Kushtetuta nuk negociohet. Vendimi përfundimtar nuk pezullohet. Detyrimi ligjor nuk mbahet peng. Pagat duhet të zhblokohen dhe vendimi duhet të zbatohet menjëherë.



Redaksia Web

Gazetar/e - Vizion Plus - Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



VENDI

**"Smart City",
Kumbaro: Kamerat...**

**Xhuljana
Zhuleku** 31 minuta
më parë



VENDI

**Nis shkolla, Kumbaro
prezanton risitë në...**

**Xhuljana
Zhuleku** 43 minuta
më parë



VENDI

**Nis sezoni i ri shkollor,
680 nxënës më pak...**

**Xhuljana
Zhuleku** 2 orë më
parë



Lajme

Programe

Rrjeti

Ligjore

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.